



# Raporti Vjetor 2019

ASCAL / 2019

[www.ascal.al](http://www.ascal.al)



*Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit. ASCAL mbështet veprimtarinë mbi Kodin e Cilësisë në arsimin e lartë dhe standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.*

*Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe në funksion të analizës së ecurisë së punës gjatë vitit 2019, ASCAL harton raportin<sup>1</sup> e përvitshëm analitik në të cilin paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtaritë kryesore të institucionit.*

ASCAL

---

<sup>1</sup> Ky raport është dokument zyrtar i ASCAL dhe përmban informacione për të cilat ky institucion është përgjegjës. Në asnjë rast, nuk lejohet tjetërsimi apo keqpërdorimi i këtij informacioni për qëllime të tjera përveç informimit të publikut. Të interesuarit që kërkojnë të kenë këto informacione dhe t'i përdorin, ato për qëllimet e tyre, janë të lutur që zyrtarisht të kontaktojnë ASCAL.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË  
QUALITY ASSURANCE AGENCY FOR HIGHER EDUCATION

**Adresa:**

*Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë, Shqipëri*

**Kontakt:**

*Drejtori (Tel/Fax) : 04 2 257954*

*Spektori i Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë (Tel/Fax): 04 2 266302*

*Spektori i Statistikave dhe Analizave (Tel/Fax): 04 2 243423*

*Spektori i Shërbimeve dhe Publikimit (Tel/Fax): 04 2 243423*

**E-Mail:** [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**website:** [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



## Shkurtime dhe fjalori shpjegues

- **ASCAL** - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë- Institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit, në bazë të ligjit nr. 80/2015,
- **BA** - Bordi i Akreditimit- Organ kolegjal vendimarrës, i cili akrediton institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit, krijuar me ligjin nr. 80/2015,
- **MASH/ MASR** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Sportit dhe Rinisë- Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin dhe rininë në Republikën e Shqipërisë
- **MPAL** - Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë
- **IAL** - Institucion i arsimit të lartë - Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, shkollat e larta, kolegjet, akademitë dhe institutet
- **PS** - Program studimi - Programe të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
- **Vlerësim** - Proces që ndjek ASCAL për të parë përputhshmërinë e një programi në kuadër të akreditimit i cili kryet nga ekspertë të fushës
- **ENQA** - Rrjeti evropian i agjencive për sigurimin e cilësisë (European Network for Quality Assurance).
- **Akreditim** - procedurë vlerësimi e cilësisë në arsimin e lartë, që ndjek ASCAL bazuar në standardet shtetërore dhe ato evropiane
- **LAL** - Ligji i arsimit të lartë
- **SSHHC** - Standardet shtetërore të cilësisë janë dokumentet themelore që përmbajnë standarde dhe kritere minimale që duhet të përmbushë çdo institucion dhe program studimi për akreditimin e plotë.
- **SKS** - Sondazhi Kombëtar i Studentëve
- **ESG** - *European standards and guidelines* - Udhëzuesit dhe standardet evropiane për sigurimin e cilësisë
- **CEENQA** - Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education
- **Koordinator i IAL** - Person kontakti i caktuar nga IAL për komunikimin me ASCAL dhe shkëmbim informacioni nëpërmjet sistemit elektronik
- **KT** - koordinatori teknik - Përfaqësuesi i ASCAL që ndjek një proces të caktuar të aplikuar nga një IAL
- **EV**- Ekspert vlerësimi i njohur në një fushë të caktuar i angazhuar nga ASCAL për një proces vlerësimi
- **AMS** - **ASCAL Management System** - sistemi i menaxhimit elektronik i ASCAL
- **GVB** - Grupi i vlerësimit të brendshëm - personat e angazhuar nga IAL për realizimin e një procesi vetëvlerësimi të institucionit apo programit dhe raportit të vetëvlerësimit
- **GVJ** - Grupi i vlerësimit të jashtëm - Përgjegjës për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm
- **DRVB** - Draftraport i vlerësimit të brendshëm - Raporti paraprak i GVB që i dorëzohet titullarit të IAL për miratimin e titullarit të IAL ose njësisë kryesore
- **RVB**-Raporti i vlerësimit të brendshëm
- **DRVJ** - Draftraport i vlerësimit të jashtëm - Raporti paraprak i GVJ që i dorëzohet ASCAL
- **RVJ** - Raporti i vlerësimit të jashtëm - Raporti i finalizuar nga GVJ
- **DPA** - Dosja e plotë e akreditimit - Dosja me dokumentacionin e plotë e përgatitur nga ASCAL për shqyrtim në BA (e printuar dhe në sistemin elektronik)

- **VBA** – Vendimi i **Bordit të Akreditimit** – Vendimi i marrë nga BA pas shqyrtimit të DPA të një procesi akreditimi
- **VKM** – Vendim i **Këshillit të Ministrave**
- **UMA** – Urdhër i **Ministrit të Arsimit**

## TABELA PËRMBLEDHËSE

|  |           |
|--|-----------|
| <b>PËRMBLEDHJE E RAPORTIT .....</b>  | <b>6</b>  |
| <b>KAPITULLI I .....</b>   | <b>7</b>  |
| <b>    INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE<br/>    FUNKSIONIMI I TYRE .....</b> | <b>7</b>  |
| 1.1. HYRJE .....   | 7         |
| 1.2. ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE .....  | 7         |
| 1.3. BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE.....  | 8         |
| 1.4. ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL/BA .....  | 8         |
| 1.5. EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM.....  | 9         |
| <b>KAPITULLI II.....</b>   | <b>11</b> |
| <b>VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA.....</b>  | <b>11</b> |
| 2.1. PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESEVE TË VLERËSIMIT .....                             | 11        |
| 2.2. AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....                     | 11        |
| 2.3. AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT .....  | 18        |
| 2.4. SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE .....  | 22        |
| 2.5. BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË<br>CILËSISË.....                 | 25        |
| 2.6. AKTIVITETI FINANCIAR.....   | 26        |
| <b>KAPITULLI III .....</b>   | <b>33</b> |
| <b>    SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE<br/>    PROCEDURAVE .....</b>           | <b>33</b> |
| 3.1. SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE .....  | 33        |
| 3.2. ADMINISTRIMI I PROCESEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË.....                               | 34        |
| 3.3. INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT .....   | 35        |
| 3.4. SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE .....                               | 36        |
| <b>KAPITULLI IV .....</b>  | <b>37</b> |
| <b>PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2020.....</b>  | <b>37</b> |

## PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Gjatë vitit 2019 ASCAL dhe BA kanë synuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri, shtrirjen e procesit të akreditimit në programet e studimit të ofruar nga IAL-të publike si dhe përfshirjen e studentëve në sa më shumë hallka të sigurimit të cilësisë. Veprimtaria e ASCAL dhe BA gjatë 2019 ka reflektuar këto objektiva duke ndërmarrë aktiviteve për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, ka zhvilluar Sondazhin Kombëtar të Studentëve dhe duke avancuar procesin e akreditimit të programeve të studimit ofruar nga IAL-të publike.

Aktivitetet kryesore të realizuara nga ASCAL dhe BA në vitin 2019 janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë raport analitik i cili bazohet në referenca dhe të dhëna empirike. Çdo e dhënë apo informacion i paraqitur në këtë raport mund të përdoret për qëllime informimi dhe studimi, por në asnjë rast ato nuk mund të keqpërdoren, tjetërsohen apo nxirren jashtë kontekstit për të cilin janë paraqitur.

ASCAL

# KAPITULLI I

## INSTITUCIONET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË DHE FUNKSIONIMI I TYRE

### 1.1. HYRJE

Hartimi dhe publikimi i 'Raporti Vjetor 2019' të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Bordit të Akreditimit (BA) rrjedh si detyrim nga pika 21/h e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 109, datë 15.02.2019, i ndryshuar. Në zbatim të këtij detyrimi ASCAL harton raportin vjetor, ia paraqet për shqyrtim dhe miratim BA dhe më pas e publikon në faqen zyrtare të institucionit. Raporti vjetor për vitin 2018 u shqyrtua dhe miratua nga BA me vendimin Nr. 44 datë 05.07.2019 dhe është publikuar në faqen zyrtare të ASCAL ku mund te gjendet edhe raporti për vitet 2016 dhe 2017. Përveç përmbushjes së detyrimit ligjor, ky raport ndërmerret edhe në funksion të analizës së punës së ASCAL / BA.

Ky raport paraqet një përmbledhje analitike të veprimtarisë së ASCAL / BA vetëm për vitin 2019 pasi raportet paraardhëse mbulojnë veprimtarinë e viteve përkatëse.

### 1.2 ASCAL: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

ASCAL është person juridik publik përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Agjencia fillimisht është krijuar me VKM Nr. 303, datë 01.07.1999<sup>2</sup> si Agjencia e Akreditimit, riorganizuar në Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë me VKM Nr. 424, datë 02.06.2010<sup>3</sup>, dhe së fundmi riorganizuar në Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me VKM Nr. 109, datë 15.02.2017<sup>4</sup>, i ndryshuar.

Agjencia ka si mision promovimin dhe sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë bazuar në disa parime themelore si: **(1)** respektimin e

---

<sup>2</sup> VKM nr. 303, datë 01.07.1999, "Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë"

<sup>3</sup> VKM nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë"

<sup>4</sup> VKM nr. 109, datë 15.02.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë"



autonomisë institucionale dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë (IAL); (2) transparencën dhe informimin në çdo hap të procesit; (3) mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAL; (4) objektivizmin dhe profesionalizmin në të gjitha proceset e kryera prej saj si dhe (5) respektimin e kriterëve dhe standardeve shtetërore të cilësisë si dhe të standardeve Europiane të cilësisë. Në veprimtarinë për përmbushjen e misionit të saj, Agjencia gëzon pavarësi në hartimin dhe miratimin e procedurave të cilat publikohen dhe bëhen transparente për aktorët në fushën e arsimit të lartë.

### 1.3 BA: MISIONI, OBJEKTIVAT DHE FUNKSIONET KRYESORE

Pranë ASCAL funksionon Bordi i Akreditimit si organ kolegjal vendimmarrës dhe i pavarur në veprimtarinë e tij. BA është vazhdues i punës së Këshillit të Akreditimit i krijuar në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007. Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e BA rrjedhin prej Ligjit 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar. Bordi i Akreditimit ka pavarësi në funksionimin e tij përsa i përket akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë.

BA përbëhet nga 11 anëtarë të cilët janë personalitete të botës akademike me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor brenda dhe jashtë vendit. Ligji Nr. 80/2015, i jep fuqinë BA-së të marrë vendimin përfundimtar mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programve që ato ofrojnë. BA bashkëpunon me institucionet që operojnë në fushën e arsimit të lartë, politikëbërjes dhe vendimarrjes duke dhënë rast pas rasti rekomandime për çështje të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Aktiviteti i BA mbështetet nga ASCAL.

### 1.4 ORGANIZIMI DHE BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ASCAL / BA

#### ***Organizimi dhe funksionimi i ASCAL***

Struktura aktuale e Agjencisë është në zbatim të VKM Nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë". Agjencia është organizuar në tre sektorë dhe numri i punonjësve është 15. Struktura organizative përbëhet nga drejtori, Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë, Sektori i Statistikave dhe Analizave, Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit. Çdo sektor drejtohet nga përgjegjësi përkatës. ASCAL ofron asistencën teknike për institucionet e arsimit të lartë, BA, ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe bashkëpunëtorët e tjerë. Duke qenë se ASCAL ende funksionon

me strukturën e APAAL, e cila nuk është e përshtatshme, përmbushja e disa detyrave funksionale të ASCAL has në vështirësi të shtuara.

### ***Baza ligjore e funksionimit të ASCAL/BA***

Në Shqipëri sistemi i akreditimit ka një përvojë 20 vjeçare dhe ka ardhur duke u konsoliduar gradualisht. Disa nga dokumentet/aktet kryesore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e ASCAL/BA janë:

- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”;
- Standardet shtetërore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (miratuar me urdhëra të ministrit përgjegjës për arsimin në 2011/2013);
- Urdhërat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin të cilat kanë efekte mbi procedurat e ASCAL në kuadrin e vlerësimit të jashtëm dhe marrëdhëniet me institucionet e arsimit të lartë;
- “Rregullore për funksionimin e brendshëm të Bordit të Akreditimit” miratuar nga BA me Vendim Ekstra Nr. 1 datë 02.02.2018;
- “Rregullore e brendshme për funksionimin e APAAL” 2014;
- “Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area” (Standardet dhe udhëzimet të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, ndryshuar në vitin 2015). Këto standarde janë reflektuar në dokumentet bazë të funksionimit të ASCAL si procedura të vlerësimit / akreditimit, etj.;
- Manuali për procedurat e akreditimit të institucioneve dhe të programeve të studimit, miratuar në vitin 2015 dhe rishikuar në vitin 2017 si dhe aspekte dhe procedura të miratuara nga BA.

### **1.5 EKSPERTËT E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në ushtrimin e veprimtarisë funksionale në kuadër të vlerësimit dhe akreditimit, ASCAL dhe BA angazhojnë ekspertë të jashtëm të vlerësimit dhe / apo konsulentë. Gjatë vitit 2019 ASCAL dhe BA kanë përditësuar dhe zgjeruar listën e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, vendas dhe të huaj, bazuar në

kualifikimet e tyre si dhe aftësinë për të dhënë një gjykim të drejtë dhe pa ndikime duke shmangur çdo konflikt të mundshëm interesi.

Në këtë kuadër, me Vendimin Nr. 15 datë 01.02.2019 të Bordit të Akreditimit u miratua hapja e thirrjes për rekrutimin e ekspertëve për vlerësimin e jashtëm sipas kriterëve të miratuara me Vendimin Nr. 44, datë 13.07.2018 të BA. Thirrja dhe kriteret u bënë publike në faqen zyrtare e rrjetet sociale të ASCAL, faqet zyrtare e rrjetet sociale të disa prej partnerëve ndërkombëtarë si: ENQA, INQAAHE dhe EVALAG, si dhe iu dërgua përmes adresave elektronike të gjithë stafëve akademike të IAL-ve në vend, publike dhe jopublike, sipas databazës së disponueshme në sistemin e menaxhimit të ASCAL (AMS).

Ndër kriteret kryesore të përfshirjes së ekspertëve vendas apo të huaj në listën e ekspertëve të jashtëm të vlerësimit ishin: kualifikimet e përshtatshme për llojin e vlerësimit, pavarësia në vlerësim, të jenë figura të njohura në fushën përkatëse të shkencës, të kenë përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjetësh në mësimdhënie dhe kërkim, të kenë të paktën gradën shkencore “Doktor”, të kenë përvojë në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, të kenë integritet personal dhe profesional, etj.

Pas shqyrtimit të aplikimeve nga grupi i punës i ngritur nga Bordi i Akreditimit, u përzgjedhën 314 aplikantë. Lista e përditësuar me ekspertët e rinj të përzgjedhur u miratua me Vendimin Nr. 43, datë 05.07.2019 të Bordit të Akreditimit. Pas pranimit si ekspertë vlerësimi, ekspertët u regjistruan në sistemin e menaxhimit të ASCAL dhe u pajisën me kredencialet përkatëse. Në 2019 ASCAL ka patur në dispozicion një databazë me **797 ekspertë** vendas dhe të huaj të fushave të ndryshme të cilët janë angazhuar rast pas rasti sipas nevojave.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2019 është vijuar me përfshirjen dhe angazhimin e ekspertëve të huaj në akreditimin institucional dhe të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë (sipas përcaktimeve ligjore). Në koordinim të vazhdueshëm, ASCAL dhe BA kanë pasuruar/përditësuar listën me ekspertë të huaj sidomos të atyre që vijnë nga diaspora akademike shqiptare.

## KAPITULLI II

### VEPRIMTARITË KRYESORE TË ASCAL DHE BA

#### 2.1 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT NË KUADËR TË PROCESIVE TË VLERËSIMIT

ASCAL, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, përgatit dhe përmirëson vazhdimisht, në koordinim me BA, dokumentat dhe formatet e nevojshme për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

Disa nga dokumentat dhe formatet kryesore që janë rishikuar ose hartuar nga e para gjatë 2019 nga ASCAL / BA janë:

- Formatet / modelet e raportit të vlerësimit të brendshëm / jashtëm për akreditimin e parë dhe periodik të programeve të studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve “*Bachelor*”, programet e studimit të ciklit të dytë “*Master profesional*”, “*Master i shkencave*” dhe “*Master i arteve*”, si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë;
- “*Manual vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Pyetësorit Kombëtar të Studentëve*” si dhe “*Plan - veprimi për realizimin e SKS*” [VBA Nr. 14, datë 01.02.2019]

#### 2.2 AKREDITIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Gjatë vitit 2019, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë ka qenë aktiviteti kryesor i ASCAL dhe BA. Në këto procese ASCAL dhe BA mbështeten në kodin e cilësisë (VKM Nr. 531, datë 11.09.2018) standardet shtetërore të cilësisë (2011/2013) dhe standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë.

Bazuar në Manualin e Procedurave 2017, procesi i akreditimit është i ndarë në faza:

##### ***Faza e aplikimit - shqyrtimi i aplikimeve***

Bazuar në Manualin e vitit 2017, IAL-të aplikojnë për akreditimin institucional ose të programeve të studimit, në formë zyrtare dhe nëpërmjet sistemit online të

menaxhimit të ASCAL (ASCAL Management System – AMS) brenda periudhës 1 Tetor – 31 Maj. Në vitin 2019, ASCAL ka shqyrtuar **184** aplikime për akreditim. Nga këto **12** kanë qënë aplikime për **akreditimin institucional** dhe **172** aplikime për **akreditim programesh**.



*Figura 1: Aplikime të shqyrtuara, 2019*

Bazuar në këto të dhëna rezulton se aplikimet për akreditim në vitin 2019 në tërësi kanë pësuar një **rritje me 35%** krahasuar me vitin 2018. Sidomos për periudhën Janar - Qershor 2019, numri i aplikimeve është dyfishuar krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018. Konkretisht, nga 136 aplikime për akreditim të shqyrtuara gjithsej gjatë gjithë viti 2018, vetëm në 6-mujorin e parë të 2019 janë shqyrtuar 110 aplikime. Burimi kryesor i rritjes ishte aplikimi për akreditim të parë të programeve të studimit nga disa IAL publike (Universiteti Ismail Qemali, Vlorë, Universiteti Fan S. Noli, Korçë, Universiteti i Mjekësisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës dhe Universiteti i Sporteve).

Numri i lartë i aplikimeve solli intensitet të lartë pune gjatë gjithë vitit 2019. Duke qënë se për IAL-të publike akreditimi i programeve të studimit po zhvillohej për herë të parë edhe problematikat me të cilat u përballën ASCAL dhe BA shpesh ishin të reja. Gjithësesi, në bashkëpunim me MASR dhe IAL-të e interesuara problemet e hasura u tejkaluan dhe procesi i akreditimit të parë të programeve të studimit të IAL-ve publike u zhvillua me sukses dhe vijon edhe në 2020.


Specifikisht, gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar 12 aplikime për **akreditim institucional** nga:

- 3 IAL publike;

- 9 IAL jo-publike.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar 172 aplikime për **akreditim programesh** si më poshtë:

- 82 aplikime nga 6 IAL publike;
- 90 aplikime nga 15 IAL jopublike.



*Figura 2: Aplikime për akreditim programesh, 2019*


Krahasuar me vitin 2018 në vitin 2019 ka patur një rritje të ndjeshme të aplikimeve për akreditim programesh nga IAL-të publike dhe një rënie të aplikimeve nga IAL-të jo-publike. Specifikisht, në vitin 2019 aplikimet për akreditim programesh nga IAL-të publike janë rritur me 382% ndërsa aplikimet për akreditim programesh nga IAL-të jo-publike kanë rënë me 22%.

Përsa i përket llojit dhe ciklit të këtyre aplikimeve, janë shqyrtuar:

- 15 programe studimi me karakter profesional;
- 68 programe studimi të ciklit të parë;
- 82 programe studimi të ciklit të dytë (46 Master profesional, 31 Master i shkencave, 5 programe të integruar të studimeve të ciklit të dytë);
- 7 programe studimi të ciklit të tretë.

Krahasimisht me vitin 2018, në vitin 2019 është rritur ndjeshëm numri i aplikimeve për programe studimi me karakter profesional (nga 1 në 15) dhe nuk ka patur aplikime për programe studimi 4 vjeçar (6 në 2018). Kjo reflekton

shtimin e ofertës akademike në fushën e studimeve profesionale dhe uljen graduale të programeve të studimit 4 vjeçar në përputhje me kriteret ligjore në fuqi.



**Figura 3:** Aplikimet e programeve, 2019 (cikli/lloji)

Gjatë fazës së shqyrtimit të aplikimeve janë kryer verifikime në disa aspekte. Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin institucional*, verifikimet janë bazuar në:

- Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu III “Institucionet e arsimit të lartë”, Neni 17-29; Kreu V “Organizimi akademik dhe administrativ i institucioneve të arsimit të lartë”, Neni 36-56;
- Udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 539, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” etj.;

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të themelimit, organizimit dhe funksionimit të IAL-ve;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të institucionit si:
  - përmbushja e kërkesave ligjore të organizimit të institucionit;
  - përmbushja e kërkesave ligjore të strukturës akademike;

- numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, drejtuesve të IAL, njësive bazë / kryesore;
- funksionimi i strukturave të sigurimit të cilësisë;
- numri i studentëve, programeve / fushave të studimit që ofron institucioni;
- verifikimin mbi masat e marra nga institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Në aplikimet e shqyrtuara për akreditim institucional, nuk janë hasur problematika që të rezultojnë në pezullimin apo anulimin e proceseve të akreditimit. Në çdo rast, ASCAL ka qenë në komunikim me institucionet e arsimit të lartë për përmbushjen e kriterëve ligjore përpara nisjes së procesit të akreditimit.

Në kuadër të aplikimeve për *akreditimin e programeve të studimit*, verifikimet janë kryer në dy nivele:

- në nivel institucioni, sipas elementëve të sipër cituar, duke patur në fokus dhe vlefshmërinë e akreditimit institucional;
- në nivel programi për të cilin është aplikuar.

Baza ligjore e verifikimeve në nivel programi është si vijon:

- Ligji 80/2015, datë 22.07.2015: Kreu VII “Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69-73, 77, 79-84;
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”;
- VKM Nr. 539, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, etj.

Verifikimet paraprake janë përqëndruar në:

- shqyrtimin e akteve ligjore të hapjes, organizimit dhe funksionimit të programit të studimit;
- verifikimin e të dhënave të përgjithshme të programit si:
  - përmbushjen e kërkesave ligjore të organizimit / strukturës së programit të studimit;
  - përputhshmërinë e fushës e drejtimeve të IAL / njësisë kryesore / njësisë bazë me programin e studimit;
  - përputhshmërinë e emërimit të programit të studimit me aktet që lidhen me organizimin / funksionimin e tij;
  - numri dhe shkalla e kualifikimit të stafit akademik, të njësisë bazë / kryesore që ofron programin e studimit;
  - numri i studentëve për programin e studimit;



- verifikimin mbi masat e marra nga Institucioni për përmbushjen e rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm (në rastet e akreditimit periodik).

Nga shqyrtimi i aplikimeve për akreditimin e programeve të studimit gjatë vitit 2019 janë hasur një sërë problematikash, kryesisht mungesë dokumentacioni, të cilat janë zgjidhur duke komunikuar me IAL-të përkatëse. Në **6 raste**, të cilat konsistojnë në mos-përputhjen midis licencimit dhe ofrimit të programit të studimit, ASCAL i është drejtuar institucioneve të tjera kompetente për sqarim / interpretim dhe ka vijuar procesin pas reagimit të institucioneve përkatëse.

Faza e aplikimeve është përmbyllur me miratimin e kërkesës dhe periudhës së vlerësimit, e cila i bëhet me dije IAL-ve sipas parashikimeve të Manualit 2017.

### ***Faza e vlerësimit – vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm***

Pas përfundimit të verifikimit paraprak, procesi kalon në fazën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

Vetëvlerësimi përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë bazohet në përgatitjen dhe paraqitjen e të dhënave institucionale, hartimin e raporteve të vetëvlerësimit dhe të dokumentacionit mbështetës/verifikues të vlerësimit. Në këtë kuadër, IAL-të dorëzojnë dokumentacionet përkatëse që përbëjnë Dosjet e Vetëvlerësimit (DVV). Dokumentacioni paraqitet në 2 gjuhë (shqip dhe anglisht) për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, programeve të integruara të ciklit të dytë si dhe të programeve të ciklit të tretë të studimeve.

Me miratimin e Kodit të Cilësisë në vitin 2018, të gjitha aplikimet për akreditimin e programeve të studimit të mbërritura në ASCAL nga 1 Tetori 2018 e në vazhdim, vlerësohen përkundrejtë standardeve të miratuara në këtë Kod. Për këtë arsye, një pjesë e madhe e institucioneve të cilat kanë aplikuar për akreditimin e programeve me karakter profesional, programeve të ciklit të parë dhe programeve të ciklit të dytë, gjatë vitit 2019 kanë kërkuar trajnimin e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm, trajnim i cili iu është ofruar nga ASCAL.

Vlerësimi i jashtëm, bazohet në analizën, vlerësimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vlerësimin përmes vizitës në institucion. Grupet e vlerësimit të jashtëm, kanë vlerësuar dhe dakordësuar gjykimet pjesore e tërësore për të gjitha institucionet dhe programet e vlerësuara në mënyrë kolegjiale. Vlerësimi mbi bazë dokumentacioni është pasuar me vizitën në institucion dhe draftimin e raportit përfundimtar bazuar në dy komponentët e vlerësimit. Grupet e vlerësimit kanë kryer vizita 2-ditore në IAL-të përkatëse

për çdo proces, ku kanë zhvilluar takime sipas agjendave të dakordësuara dhe dërguar paraprakisht institucioneve.

Në përfundim, grupet e vlerësimit të jashtëm kanë hartuar draft-raportet e vlerësimit të cilat u janë dërguar institucioneve për komente apo sqarime. Proceset janë përmbyllur me hartimin e raportit përfundimtar i cili, përveç pjesës së vlerësimit përkundrejt standardeve, përcakton “gjetjet” e vlerësimit ku përfshihen pikat e forta, të dobëta, mundësitë, pengesat dhe rekomandimet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Mbështetur në rezultatet e vlerësimit përkundrejt standardeve, ekspertët japin gjykimet e tyre në lidhje me fushat e veçanta dhe vlerësojnë shkallën e përmirësimit të Standardeve të Cilësisë sipas kategorive:

- *Nuk përmirësohen;*
- *Përmirësohen pjesërisht;*
- *Përmirësohen kryesisht;*
- *Përmirësohen plotësisht.*

Gjatë vitit 2019, ASCAL ka qënë i angazhuar në një numër të madh procesesh vlerësimi në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit. Në vitin 2019 **janë përfunduar 107 procedura: 2 akreditime institucionale të pjesshme dhe 105 akreditime programesh studimi.** Të dhënat për procedurat e akreditimit sipas llojit të programeve paraqiten në tabelën më poshtë.

**Tabela 1:** Procedurat e akreditimit sipas llojit të programeve

| Llojet e vlerësimeve  | Numri i vlerësimeve |
|---|---------------------|
| Programe 2 vjeçare profesionale   | 3                   |
| Bachelor  | 40                  |
| Master Profesional  | 32                  |
| Master i Shkencave  | 24                  |
| Master i Shkencave (PI)   | 5                   |
| SPA   | 1                   |
| Doktoratë   | 0                   |
| Akreditime institucionale/të pjesshme                                   | 2                   |
| <b>105 Programe /</b><br><b>2 akreditime institucionale të pjesshme</b> | <b>107</b>          |

Në kuadër të procedurave të akreditimit, ASCAL ka realizuar trajnime me grupet e vlerësimit të brendshëm (GVB) dhe grupet e vlerësimit të jashtëm (GVJ). Në këto trajnime grupet njihen me mënyrën e hartimit të raporteve të jashtëm dhe të brendshëm, menaxhimin dhe verifikimin e dokumentacionit për proceset e vlerësimit, organizimin dhe koordinimin e vizitës në institucion, etj.

Gjatë vitit 2019 ASCAL ka realizuar trajnime dhe vizita në institucione si vijon:

- **25 trajnime** për Grupet e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit (5 në IAL publike dhe 20 në IAL jopublike);
- **93 ekspertë** të trajnuar në grup dhe individualisht;
- **217 ekspertë** të angazhuar në kuadër të akreditimeve nga të cilët 25 të huaj dhe 192 vendas;
- **107 vizita** në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit;
- **214 ditë** vizitash të realizuara në kuadër të akreditimeve institucionale dhe programeve të studimit.

### 2.3 AKTIVITETI I BORDIT TË AKREDITIMIT

BA funksionon pranë ASCAL bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017, i ndryshuar dhe ka kompetencën e vendimmarrjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. Vendimi për akreditimin mund të jetë pozitiv ose negativ. Në rastin e një vendimi pozitiv, BA shprehet për kohëzgjatjen dhe vlefshmërinë e akreditimit dhe mund të vendosë rekomandime për institucionet në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

Mbledhjet e BA janë organizuar bazë të një kalendari të hartuar në përputhje me numrin e aplikimeve që janë për t'u shqyrtuar. Në lidhje me aktivitetin e BA, disa nga veprimtaritë kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2019 janë si vijon:

- *Shqyrtimi dhe vendimmarrja në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;*
- *Shqyrtimi i aplikimeve dhe miratimi i listës së ekspertëve;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i dokumentacionit në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS);*

- *Organizimi i aktiviteteve në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.*

Gjatë vitit 2019, Bordi i Akreditimit ka realizuar 7 mbledhje dhe ka marrë vendime si më poshtë:

**Tabela 2: Aktiviteti i detajuar i BA**

| Aktiviteti i BA 2019 |                   |                    |  |   |              |
|----------------------|-------------------|--------------------|--|---|--------------|
|                      | Mbledhja BA       | Vendime            | Akreditim IAL  | Akreditim programi                                  | Proceduriale |
|                      | 1 Shkurt          | 16                 |  | 12 (IAL jo-publike)                                 | 4            |
|                      | 2 Mars            | 6                  |  | 5 (IAL jo-publike)                                  | 1            |
|                      | 12 Prill          | 13                 |  | 13 (IAL jo-publike)                                 |              |
|                      | 31 Maj            | 8                  |  | 7 (IAL jo-publike)                                  | 1            |
|                      | 5 Korrik          | 24                 | 2<br>(Akreditim i pjesshëm / IAL jo-publike)         | 18<br>(IAL jo-publike)                              | 4            |
|                      | 4-5 Tetor         | 26                 |  | 25<br>(7 IAL publike / 18 IAL jo-publike)           | 1            |
|                      | 1-2 Nëntor        | 25                 |  | 25<br>(6 IAL publike / 19 IAL jo-publike)           |              |
| <b>Total</b>         | <b>7 Mbledhje</b> | <b>118 vendime</b> | <b>2<br/>(Akreditim i pjesshëm / IAL jo-publike)</b> | <b>105<br/>(13 IAL Publike / 92 IAL jo-publike)</b> | <b>11</b>    |

**Tabela 3: Aktiviteti i përmbledhur i BA**

| INSTITUCIONET                    | PUBLIKE   | JO-PUBLIKE | TOTALI     |
|----------------------------------|-----------|------------|------------|
| Akreditime IAL/të pjesshme       |           | 2          | 2          |
| Akreditime programesh            | 13        | 92         | 105        |
| Tjetër (ndryshim vendimesh, etj) |           | 11         | 11         |
| <b>TOTALI</b>                    | <b>13</b> | <b>94</b>  | <b>118</b> |

Rezultatet e akreditimit të IAL-ve dhe programeve të studimit, raportet e vlerësimit dhe vendimet përkatëse të BA janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL. Në vendimmarrjet e shqyrtuara gjatë vitit 2019, BA ka dhënë vlerësime pozitive për institucionet dhe programet e studimit të vlerësuara. Ndarja sipas kategorive dhe kohëzgjatjes së vlerësimit, jepet në mënyrë të përmbledhur në tabelat më poshtë.

**Tabela 4:** Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit

| Vendimmarrja për:              | Kohëzgjatja e akreditimit (vite) |   |    |    |    |    |                | Total | Mesatarja | Jo publike / Publike |
|--------------------------------|----------------------------------|---|----|----|----|----|----------------|-------|-----------|----------------------|
|                                | 1                                | 2 | 3  | 4  | 5  | 6  | Tjetër         |       |           |                      |
| <b>Akreditim Institucional</b> | -                                | - | -  | -  | -  | -  | 2 <sup>5</sup> | 2     |           | 2/0                  |
| <b>Akreditim Programesh</b>    | 3                                | 7 | 17 | 23 | 27 | 20 | 8 <sup>6</sup> | 105   | 3.8       | 92/13                |
| <b>Total</b>                   | 3                                | 7 | 17 | 23 | 27 | 20 | 10             | 107   | 3.8       | 94/13                |

**Tabela 5:** Të dhëna për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së akreditimit sipas cikleve të studimit

| Vendimmarrja për        | Kohëzgjatja e akreditimit (vite) |   |   |   |    |   |                     | Total | Mesatarja | Jo publike / Publike |
|-------------------------|----------------------------------|---|---|---|----|---|---------------------|-------|-----------|----------------------|
|                         | 1                                | 2 | 3 | 4 | 5  | 6 | Tjetër <sup>7</sup> |       |           |                      |
| <b>Akreditim DP</b>     |                                  |   |   | 1 | 1  | 1 |                     | 3     | 5         | 3/0                  |
| <b>Akreditim Bsc</b>    |                                  |   | 8 | 8 | 13 | 7 | 4                   | 40    | 4         | 34/6                 |
| <b>Akreditim MP</b>     | 3                                | 3 | 7 | 7 | 5  | 4 | 2                   | 31    | 3.4       | 29/2                 |
| <b>Akreditim Msc</b>    |                                  | 3 | 2 | 4 | 7  | 7 | 2                   | 25    | 4.2       | 21/4                 |
| <b>Akreditim Msc PI</b> |                                  | 1 |   | 3 | 1  |   |                     | 5     | 3.8       | 4/1                  |
| <b>Akreditim SPA</b>    |                                  |   |   |   |    | 1 |                     | 1     | 6         | 1/0                  |

<sup>5</sup> Akreditimet institucionale të pjeshme ku është ruajtur kohëzgjatja e akreditimit të dhënë në vendimin e mëparshëm të akreditimit.

<sup>6</sup> BA është shprehur për akreditimin e programeve të studimit për breza të caktuara të studentëve të regjistruar/diplomuar në to.

<sup>7</sup> Shiko referencën 2.

|              |   |   |    |    |    |    |   |            |            |              |
|--------------|---|---|----|----|----|----|---|------------|------------|--------------|
| <b>Total</b> | 3 | 7 | 17 | 23 | 27 | 20 | 8 | <b>105</b> | <b>3.8</b> | <b>92/13</b> |
|--------------|---|---|----|----|----|----|---|------------|------------|--------------|

Në zhvillimin e aktitetit të tij BA ka patur mbështetjen e ASCAL. Sekretariati i BA ka mbështetur aktivitetin e BA duke kryer këto funksione:

- Ndjek procedurat të cilat kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e BA;
- Harton draft-agjendën dhe ia përcjell për sugjerime / konfirmim BA;
- Përgatit dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për mbledhjen e BA, sipas agjendës së mbledhjes;
- Kujdeset për hapjen, mbarëvajtjen dhe përditësimin e procedurës së hapur në sistemin AMS për mbledhjen e BA;
- Mban kontakte me BA duke informuar për çështjet që lidhen me BA;
- Mban procesverbalin e mbledhjes së BA, ia përcjell anëtarëve të BA dhe sigurohet që të siglohet nga të gjithë anëtarët në mbledhjen e radhës;
- Arkivon dokumentacionin që lidhet me mbledhjet e BA;
- Drafton, zbardh dhe publikon shkresat / vendimet e BA;
- Regjistron certifikatat e akreditimit institucional/programeve të studimit në regjistrin e certifikatave dhe njofton IAL për tërheqjen e tyre.

Përveç vendimmarjes për akreditimin e IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë, BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar edhe në një sërë veprimtarishë, si më poshtë:

Bazuar në VKM Nr. 109 datë 15.02.2017, i ndryshuar, BA shqyrton ankesat e IAL-ve mbi procesin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe shprehet me vendim të arsyetuar në lidhje me këto ankesa, duke vendosur pranimin ose mos pranimin e ankesës. Për vitin 2019 BA ka shqyrtuar 5 ankesa dhe është shprehur për secilën me një vendim të arsyetuar. Gjithashtu gjatë vitit 2019, duke marrë shkas nga shqyrtimi i një shkresë/kërkese të një IAL-je, BA i ka dërguar MASR një shkresë “*Mbi vlefshmërinë e akreditimit të programeve të riorganizuara*”.

Siç u përmend edhe më sipër, gjatë vitit 2019 BA, në koordinim me ASCAL, ka qenë i angazhuar në zgjerimin dhe përditësimin e listës me ekspertë vendas dhe të huaj të akreditimit. Pas Vendimit Nr. 15 datë 01.02.2019 të Bordit të Akreditimit, ASCAL publikoi thirrjen e hapur për ekspertë vlerësimi të cilët u vlerësuan në bazë të kritereve të miratuara me Vendimin Nr. 44, datë 13.07.2018 të BA. Pas shqyrtimit nga grupi i punës i ngritur nga BA, u përzgjedhën 314 aplikantë. Lista e përditësuar me ekspertët e rinj u miratua me Vendimin Nr. 43, datë 05.07.2019 të BA. Gjithashtu, BA në bashkëpunim me ASCAL, ka përditësuar në kohë reale listën e ekspertëve duke vënë fokusin tek përfshirja e diasporës akademike shqiptare.

Përsa i përket Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS), BA, në koordinim me ASCAL, gjatë vitit 2019 vijoi angazhimin dhe vendimmarrjen e nisur në vitin 2018. Specifikisht, nëpërmjet Vendimit Nr. 14, datë 01.02.2019, BA rishikoi dhe miratoi “Manuali vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Pyetësorit Kombëtar të Studentëve” ku u bazua SKS si dhe “Plan - veprimi për realizimin e SKS”. Pas përpunimit paraprak të të dhënave të SKS, ASCAL i paraqiti BA raportin për shqyrtim. Pas shqyrtimit BA kërkoi një sërë ndryshimesh në mënyrën se si ishte strukturuar raporti dhe se si ishin analizuar dhe paraqitur të dhënat. Gjatë vitit 2019 BA dhe ASCAL kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për analizën e të dhënave dhe strukturimin e raportit të SKS.

Së fundmi, BA, më 12 Qershor 2019, në bashkëpunim me London School of Economics dhe ASCAL organizoi një workshop me temë: “Sigurimi i brendshëm dhe rritja e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë”. Ky workshop kishte në fokus rritjen dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë si një instrument për plotësimin e kërkesave të studentëve për një arsim më cilësor. Në aktivitet morën pjesë Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Besa Shahini, Kryetari i Bordit të Akreditimit Z. Arjan Gjonça, anëtarë të BA si dhe drejtues nga të gjithë institucionet publike të arsimit të lartë<sup>8</sup>.

## 2.4 SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, një nga mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë është vlerësimi i mësimdhënies edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Nëpërmjet SKS, ASCAL dhe BA synojnë të vlerësojnë se në çfarë mase IAL-të zbatojnë standardet e cilësisë, parë nga këndvështrimi i studentëve. Gjatë vitit 2019 ASCAL dhe BA kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me IAL-të dhe të angazhuar në përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme, setit të pyetjeve dhe versionit on line për shpërndarjen e pyetësorëve.

Puna për realizimin e SKS ka filluar që në Korrik të vitit 2017. Fillimisht u ngrit një grup pune me përbërje nga ASCAL dhe BA, për analizën e pyetësorëve të zhvilluar në kuadër të akreditimit me QAA e cila vijoi me përgatitjen e metodologjisë dhe përmbajtjes së sondazhit të studentëve, infrastrukturës/logjistikës etj. Pas analizës së kryer grupi i punës përgatiti “Manualin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Sondazhit

<sup>8</sup> <https://ascal.al/sq/informacione/aktivitete/ascal-dhe-bordi-i-akreditimit-organizojne-workshop-mbi-sigurimin-e-cilesise-per-ial-te-publike>

Kombëtar të Studentëve” dhe “Pyetësozin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies” të cilat u shqyrtuan dhe miratuan me vendim të BA, Nr. Ekstra 2, datë 30.03.2018.

Në grupet e punës për hartimin e pyetjeve u përfshinë studentë të cilët propozuan ndryshime veçanërisht në thjeshtimin e pyetjeve. Bashkëpunimi me studentët ka vazhduar në të gjitha fazat e realizimit që prekin hartimin, përmbajtjen, dhe administrimin e SKS. Këshillat Studentorë, aty ku kanë qenë funksionalë, me kërkesë të ASCAL, kanë qenë pjesë e grupeve të punës të ngritur në çdo institucion.

Gjatë periudhës Janar - Prill 2018, ASCAL ka qenë në kontakt me IAL-të për nisjen e SKS. U njoftuan titullarët e institucioneve për zhvillimin e SKS dhe iu kërkuar të përgatisin dhe dorëzonin listat e studentëve me kontaktet e tyre. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe u organizua nga ASCAL dhe BA një takim informimi me drejtuesit e Këshillave Studentore për t'i informuar rreth SKS dhe për të marrë mendimin e tyre. Pavarësisht angazhimit, procesi u ndërpre pasi gjatë kësaj periudhe, në IAL-të publike u zhvilluan zgjedhjet për Këshillat Studentore në përputhje me ligjin 80/2015. Meqënëse, bazuar në Manualin për zhvillimin e SKS, bashkëpunëtorët kryesorë të procesit janë studentët dhe strukturat e tyre, ky proces u konsiderua i pamundur të zhvillohej deri në përfundim të riorganizimit të këtyre strukturave.

Në vitin 2019, plani fillestar i veprimtarive u bë objekt i ndryshimeve pas miratimit të Kodit të Cilësisë dhe VKM Nr. 783, datë 26.12.2018 “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve”. Kështu, me vendimin Nr. 14, datë 01.02.2019, BA rishikoi dhe miratoi “Manuali vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet Pyetësorit Kombëtar të Studentëve” ku u bazua SKS si dhe “Plan - veprimi për realizimin e SKS”.

Pas këtyre përditësimeve, ASCAL vijoi procedurën për zhvillimin e SKS. Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, përgatiti materialet për shqyrtim nga BA dhe në faqen zyrtare të ASCAL u hap seksioni i posaçëm i SKS në të cilin u publikuan informacionet dhe aktivitetet e zhvilluara.<sup>9</sup> Agjencia u angazhua tërësisht në përgatitjen e infrastrukturës ku përfshihej platforma, databaza, serveri për ruajtjen dhe arkivimin e informacioneve, etj. Njëkohësisht u informuan institucionet me procesin, planin e veprimtarive si dhe me agjendat për takimet trajnuese / informuese me grupet e punës dhe studentët. Përpara nisjes së takimeve informuese, në koordinim me BA, në Fakultetin e Shkencave të

---

<sup>9</sup> <https://ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat>



Natyrës në datë 07.03.2019 u pilotua SKS me studentë të ciklit të parë. Reagimet/reflektimet e studentëve iu përcollën BA i cili pas shqyrtimit i reflektoi në një sërë ndryshimesh të pyetësorit të finalizuara në datë 21.03.2019.

Në datë 25.03.2019 ASCAL filloi turin e takimeve informuese për SKS. Gjatë periudhës **25 Mars – 10 Prill**, u zhvilluan **84 takime** me grupet e punës dhe me studentë të IAL-ve përkatëse. U kontaktuan/trajnuan rreth **321 anëtarë** të grupeve të punës të ngritur pranë IAL-ve dhe rreth **4287 studentë** të cilëve u është shpërndarë dhe broshura informuese e përgatitur për këtë qëllim.<sup>10</sup> Takimet janë zhvilluar në të gjithë IAL-të e vendit në 8 qytete (Shkodër; Tiranë; Durrës; Elbasan; Pogradec; Korçë; Vlorë; Gjirokastrë). Aktivitetet në kuadër të këtyre takimeve janë publikuar në kohë reale në faqen zyrtare të ASCAL<sup>11</sup>.

Paralelisht me zhvillimin e takimeve informuese, vijoi puna për përgatitjen e infrastrukturës për zhvillimin e SKS. Gjatë periudhës **25 Mars – 15 Prill, 2019** ASCAL finalizoi versionin on line të SKS duke:

- përgatitur në platformë pyetësorin në tre gjuhë: shqip / anglisht / italisht;
- përgatitur formatet e komunikimit me studentët: teksti hyrës i sondazhit; formatet e ftesës, email konfirmimi; email kujtese, etj;
- kryer testet e nevojshme me pyetësorin online;
- krijuar 41 pyetësorë të dedikuar për çdo IAL;
- krijuar llogari për akses individual të studentëve.

Në **16 Prill 2019** u hap zyrtarisht dhe u shpërnda SKS me email në adresat e studentëve në 41 Institucionet e Arsimit të Lartë në vend (15 IAL publike dhe 26 IAL jo-publike). Gjatë periudhës së plotësimit të Sondazhit, ASCAL ka mbajtur komunikime të vazhdueshme nëpërmjet AMS me koordinatore të IAL-ve, ku i ka informuar për nivelet e pjesëmarrjes dhe ka kërkuar nga ata marrjen e masave për informimin e vazhdueshëm të studenteve për zhvillimin e SKS.

Gjatë fazës së plotësimit të SKS, studentët kanë patur ndihmën e ASCAL nëpërmjet komunikimeve në adresën e dedikuar të email: [survey@ascal.al](mailto:survey@ascal.al). Në këtë adresë kanë mbërritur mbi **190 komunikime** nga studentë të cilët janë ndihmuar/sqaruar nga ASCAL për zgjidhjen e problematikave të ndryshme si: arsyen/qëllimin e zhvillimit të SKS, rëndësinë e tij, ruajtjen e anonimatit, probleme teknike, ankesa për numrin e madh të pyetjeve, etj. ASCAL u është përgjigjur të gjithë emaileve të dërguar nga studentët. Gjithashtu, një numër i madh komunikimesh ka ardhur edhe në adresën [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al) nga studentë të cilët kanë shprehur ankesa se nuk u ishte dërguar email për plotësimin e

<sup>10</sup> <https://ascal.al/media/documents/sks/broshura.pdf>

<sup>11</sup> <https://ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/takimet-informuese>

sondazhit. Për këto raste ASCAL ka bërë verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar që kontaktet e tyre mungonin në listat e dërguara nga IAL.

Në total nga të gjitha IAL-të në vend u vunë në dispozicion 109850 kontakte studentësh në të gjitha ciklet e studimit (84338 IALP, 25512 IALJP). Nga këto e-maile, pas verifikimit të kryer nga ASCAL rezultoi se 105846 (78882 IALP, 25279 IALJP) plotësonin kriterin e një adrese e-maili që pranohej nga platforma e SKS. Në përfundim të procesit të shpërndarjes, rezultoi se 14642 adresa (11977 IALP, 2665 IALJP) ishin jo funksionale ose jo në përdorim, (të verifikuara nëpërmjet e-maileve të kthyer)

Gjatë fazës së plotësimit të Sondazhit u zhvilluan dhe aktivitete të tjera duke patur në fokus studentët, sensibilizimin dhe informimin e tyre për SKS. I tillë ishte aktiviteti promovues i SKS, i zhvilluar në datë 19 Prill 2019, në Pallatin e Kongreseve me pjesëmarrjen e Kryeministrit Z. Edi Rama dhe Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Znj. Besa Shahini.

Me mbylljen e platformës online në datë 5 Maj 2019, u eksportuan rezultatet dhe filloi përpunimi i tyre. Analiza e të dhënave ka qenë një proces kompleks i cili ka kërkuar kohë dhe burime njerëzore. Të dhënat janë marrë në shqyrtim dhe i janë nënshtruar analizave për t'u bërë pjesë e një raporti ku do të jepen rezultate të përgjithshme dhe në anekse do të paraqiten rezultatet e plota për IAL sikundër janë dhënë nga studentët. Gjatë vitit 2019, siç u sqarua dhe më sipër, BA dhe ASCAL kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm për strukturimin dhe finalizimin e raportit të SKS. Raporti i SKS planifikohet të bëhet publik gjatë vitit 2020, pasi të jetë shqyrtuar nga BA dhe do t'i vihet në dispozicion MASR dhe institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.

## 2.5 BASHKËPUNIMI ME RRJETET NDËRKOMBËTARE TË AGJENCIVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË

ASCAL është anëtare me të drejta të plota në CEENQA, INQAAHE, dhe anëtare e asociuar e ENQA. Agjencia ka bashkëpunuar aktivisht me këto rrjete, ka marrë pjesë në veprimtaritë e organizuara prej tyre dhe veçanërisht në aktivitetet e organizuar nga ENQA. Në këtë kuadër ASCAL mori pjesë në Forumin 9 të ENQA, në datë 25-26 Prill 2019 ku u mbajtën prezantime dhe u diskutua në lidhje me përmirësimin e strategjisë dhe vizionin e ENQA.<sup>12</sup>

Gjatë aktiviteteve ku ka marrë pjesë, ASCAL ka prezantuar dhe informuar bashkëpunorët për aktivitetet që kryen dhe angazhimet për anëtarësimin me

<sup>12</sup> <https://ascal.al/sq/informacione/lajme/ascal-ne-forumin-e-9-te-enqa>

të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimin në EQAR. Përfundimet e nxjerra nga këto aktivitete kanë qënë objekt diskutimi në ASCAL dhe janë reflektuar në aktivitetin e Agjencisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 ASCAL aktivisht ka ndërtuar ura bashkëpunimi me aktorë vendas dhe të huaj për të marrë pjesë si institucion partner në programe të financuara nga Bashkimi Europian që kanë në fokus arsimin e lartë, strukturimin e programeve të studimit dhe kurrikulave, lidhjen e programeve të studimit me tregun e punës si dhe sigurimin e cilësisë. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2019, ASCAL ka është bërë pjesë e 5 konsorciumeve që kanë aplikuar për financim nga programi Erasmus+ i Bashkimit Europian. Vlen të theksohet se një nga këto konsorciume (aplikime) udhëhiqet nga ENQA dhe projekti ka si synim asistencën teknike për transpozimin e plotë të ESG-ve në legjislacionin e vendeve si Shqipëria që ende nuk e kanë arritur një gjë të tillë.

Po aq e rëndësishme, në vitin 2019 ASCAL arriti të siguronte mbështetjen financiare të ‘Bologna peer support group on quality assurance’ për 2 mobilitete për vitin 2020 të stafit të ASCAL në agjencitë e sigurimit të cilësisë në Bullgari dhe Kroaci për të përfituar nga eksperiencia e tyre sidomos përsa i përket hapave të ndërmarra nga to për anëtarësim me të drejta të plota në ENQA.

## 2.6 AKTIVITETI FINANCIAR


ASCAL, sipas buxhetit të vitit 2019, kryen dhe mbështet aktivitetin e vet financiar. Në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit Nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisë të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, shkresat e Ministrisë së Financave “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korente për vitin 2019”, ligjit 80/2015 dhe Vendimit Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, ASCAL financohet në mënyrë të balancuar nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj. Për vitin financiar 2019 ASCAL-it nuk iu akorduan fonde nga buxheti i shtetit dhe mbështeti aktivitetin financiar në të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e vet si më poshtë:


**Tabela 6:** Buxheti nga të ardhurat dhe realizimi për vitin 2019

| Nr. | Kap. | Emërtimi           | Llogaria ekonomike | Plani/lekë | Fakti/lekë | Realizuar në % |
|-----|------|--------------------|--------------------|------------|------------|----------------|
| 1   | 6    | Paga               | 6000000            | 20,000,000 | 15,641,552 | 78%            |
| 2   | 6    | Sigurime shoqërore | 6010000            | 3,500,000  | 2,172,928  | 62%            |

|   |   |                                    |         |                   |                   |     |
|---|---|------------------------------------|---------|-------------------|-------------------|-----|
| 3 | 6 | Shpenzime operative                | 6020000 | 69,612,633        | 28,187,045        | 40% |
| 4 | 6 | Shpenzime Organizata Ndërkombëtare | 6050000 | 1,525,035         | 441,538           | 29% |
| 5 | 6 | Investime                          | 2310000 | 2,000,000         | 987,900           | 49% |
|   |   | <b>Totali</b>                      |         | <b>96,637,668</b> | <b>47,800,948</b> |     |

- Në zërin shpenzime operative janë përfshirë të gjitha të ardhurat e trashëguara deri në 31 dhjetor 2018;
- Fondi i investimeve (2,000,000 lekë) është çelur nga të ardhurat e periudhës Janar -Shkurt 2019.





Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga ASCAL sipas Ligjit 80/2015 dhe VKM Nr. 109, datë 15.02.2017, i ndryshuar, shpërndahen si vijon: 10% në buxhetin e shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë. Ato evidentohen, autorizohen dhe përdoren me strukturë të vecantë buxhetore në kapitullin 6, “Të ardhura jashtë limitit”.

ASCAL trashëgoi të ardhura nga viti 2018: **37,993,887 lekë** dhe të ardhura ndër vite: **56,643,781 lekë**, duke siguruar një buxhet për vitin 2019 në vlerën: **94.637.668 lekë**. Fondet sipas zërave (paga art.600; sigurimet shoqërore art. 601; shpenzime operative, art. 602 , shpenzime operative 605 dhe investime 231) janë të detajuar në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 7:** Të ardhura të arkëtuara për vitin 2019

| Nr. | Kapitulli | Të ardhura 6 mujori 2019 | Lloji i të ardhurave  | Arkëtuar          | Pjesa e Buxhetit | Pjesa e institucionit | Rritje e autorizuar |
|-----|-----------|--------------------------|---|-------------------|------------------|-----------------------|---------------------|
| 1   | 6         | 7,190,990                | Shërbimet që kryen ASCAL institucioneve të arsimit të lartë | 56,206,978        | 5,620,697        | 50,586,280            | 2,000,000           |
|     |           |                          | <b>Totali</b>   | <b>56,206,978</b> | <b>5,620,697</b> | <b>50,586,280</b>     | <b>2,000,000</b>    |

Krahasuar me vitin 2018 ASCAL ka siguruar të ardhura në këto vlera:


- 12 mujori i vitit 2018 pjesa që i takon institucionit ishte **37,993,887** lekë;
- 12 mujori i vitit 2019 pjesa që i takon institucionit është **50,586,280** lekë;
- Për vitin 2019 ASCAL ka siguruar të ardhura më shumë në vlerën e 12,592,393 lekë, si pasojë e aplikimit të një numri të konsiderueshëm të institucioneve publike të arsimit të lartë për akreditimin e programeve të studimit.

Vlerën **28,628,583 lekë** (të ardhura të arkëtuara nga IAL-të) në zërin *shpenzime operative*, ASCAL-i e përdori për:

- Pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj;
- Mbulimin e shpenzimeve operative dhe të funksionimit të BA;
- Pagesën e anëtarëve të BA dhe shpenzime të tjera të tij;
- Pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare;
- Pagesat për udhëtime dhe dieta të stafit të ASCAL për aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit;
- Investime.

**Tabela 8:** Përdorimi i të ardhurave për vitin 2019

| <b>Shpenzimet operative / Llogaria ekonomike 602.0000</b> |   |  |                         |   |
|---|---|--|-------------------------|---|
| <b>Nr.</b>  | <b>Emërtimi i shpenzimeve</b>   | <b>Gjendja e trashëguar deri me 31 dhjetor të vitit 2018</b> | <b>Përdorur në fakt</b> | <b>% që zë secili zë në totalin e shpenzimeve</b> |
| 1   | Shpenzime operative   | 94,637,668   |                         |   |
| 2   | Shpenzime për pagesën e honorareve të Bordit të Akreditimit (Të huaj dhe vendas)  |  | 4,978,435               | 17%   |
| 3   | Shpenzime për pagesën e honorareve të ekspertëve vendas dhe të huaj   |  | 16,275,005              | 57%   |
| 4   | Shpenzime udhëtim e qëndrimi brenda dhe jashtë vendit të punonjësve të ASCAL, Bordit të Akreditimit dhe ekspertëve të huaj. |  | 3,280,561               | 11%   |
| 5   | Shpenzime të ndryshme, detyrime ndaj të tretëve, qera salle, shtypshkrime, përkthime organizime ëorkshop etj...             |  | 3,653,044               | 13%   |
| 6   | Shpenzime për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizatat   |  | 441,538                 | 2%  |
|   | <b>TOTALI</b>   |  | <b>28,628,583</b>       |   |



Çdo muaj për arkëtimet e ASCAL bëhet akt-rakordimi me Degën e Thesarit Tiranë nënshkruar nga punonjësja e Degës së Thesarit dhe ASCAL. Nga sa më sipër, jepet informacion i detajuar MASR mbi të ardhurat, realizimet sipas zërave të përcaktuar në bazën ligjor të sipërcituar.

Gjatë vitit 2019 në ASCAL janë aktivizuar 192 ekspertë vendas dhe 25 të huaj të kualifikuar për vlerësimin e programeve të studimit në arsimin e lartë, ndaj të cilëve janë kryer pagesat për:

1. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve 2 vjeçare profesionale, ekspert vendas:
  - a) në Kolegjin Profesional të Tiranës;
  - b) në Universitetin "Metropoliran Tirana";
  
2. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të parë, Bsc, ekspert vendas:
  - a) në Kolegjin Universitar "Bedër";
  - b) në Kolegjin Universitar "Logos";
  - c) në Kolegjin Universitar "Luarasi";
  - d) në Universitetin "Polis";
  - e) në Universitetin Bujqësor i Tiranës;
  - f) në Universitetin "Metropoliran Tirana";
  - g) në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë";
  - h) në Universitetin Privat "Albanian University";
  - i) në Kolegjin Universitar "LOGOS";
  - j) në Shkollën e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti";

- k) në Kolegjin Universitar "Qiriazi";
  - l) në "Universiteti i NewYork-ut në Tiranë";
3. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë, MP, ekspert vendas:
- a) në "Universiteti i New York-ut në Tiranë";
  - b) në Universitetin Privat "Albanian University";
  - c) në Kolegjin Universitar "Luarasi";
  - d) në Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti"";
  - e) në Universitetin "Polis";
  - f) në Universitetin "Aldent";
  - g) në Universiteti Europian i Tiranës;
  - h) në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë";
  - i) në Universitetin "EPOKA";
  - j) në Kolegjin Universitar "Qiriazi";
4. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë, Msc dhe Msc i integruar, ekspert vendas:
- a) në Universitetin Privat "Albanian University";
  - b) në Kolegjin Universitar "Bedër";
  - c) në "Universiteti i New York-ut në Tiranë";
  - d) në Universitetin "Polis";
  - e) në Universitetin Bujqësor i Tiranës;
  - f) në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë";
  - g) në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë";
  - h) në Kolegjin Universitar "Luarasi";
  - i) në Kolegjin Universitar "Qiriazi";
  - j) në Universitetin "Aldent";
  - k) në Shkolla e lartë universitare, jopublike, "Universiteti "Marin Barleti"";
5. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të dytë, Msc dhe Msc i integruar, ekspert të huaj:
- a) në Kolegjin Universitar "Bedër";
  - b) në "Universiteti i New York-ut në Tiranë";
  - c) në Universitetin "Polis";
  - d) në Universitetin Bujqësor i Tiranës;
  - e) në Universitetin "Mesdhetar i Shqipërisë";
  - f) në Kolegjin Universitar "Luarasi";
  - g) në Kolegjin Universitar "Qiriazi";
6. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të ciklit të tretë, Dr me ekspert të huaj:
- a) në Universitetin Privat "Albanian University";



7. Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit institucional me ekspert të huaj:

- a) në Universitetin Privat "Albanian University";
- b) në Akademia e Filmit dhe Multimedias "Marubi"

Në zbatim të Ligjit Nr.7661 datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin", VKM Nr.248 datë 10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe njësisve që varen prej tyre", Udhëzimit "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018", dhe shkresës së MASR gjatë muajit shkurt 2019 janë hartuar pasqyrat financiare për vitin 2018, duke mbyllur kështu bilancin ekonomiko-financiar të ASCAL, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe dorëzuar pranë MASR pa asnjë kontestim.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimit Publik", Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.4 datë 04.07.2012 "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operator ekonomik" i ndryshuar, është hartuar Regjistri i Prokurimeve Publike, në vijim të të cilit janë kryer prokurime të blerjeve me vlera të vogla për llojet e shërbimeve si më poshtë:

- Kancelari;
- Shërbime e e-mail, interneti;
- Shpenzime të printimit, publikimi, botime;
- Shpenzim udhëtim i jashtëm (ekspertët e huaj, anëtarët e BA);
- Shpenzime qëndrimi (ekspertët e huaj, anëtarët e BA);
- Shpenzime për qiramarrje ambjentesh (konferenca, dhe mbledhje BA);
- Blerje pajisje (Fotokopje + kompjutera);
- Blerje orendi zyre.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, falë rritjes së numrit të aplikimeve nga IAL-të publike si dhe mirë-menaxhimit ndër vite të të ardhurave nga ASCAL, gjendja financiare e Agjencisë konsiderohet e qëndrueshme. Duke qenë se të ardhurat e Agjencisë varen nga numri i aplikimeve për akreditime institucionale dhe të programeve të studimit të cilat iniciohen nga vetë IAL-të është e vështirë të parashikohen të ardhurat e viteve të ardhshme. Gjithësesi, nëse tendencat e dy viteve të fundit vazhdojnë edhe në të ardhmen e afërt, besojmë që Agjencia do të ketë burime të mjaftueshme për të financuar detyrat e saj funksionale.

## KAPITULLI III

### SISTEMI I RUAJTJES DHE ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT DHE PROCEDURAVE

#### 3.1 SISTEMI I MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

ASCAL, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale, monitoron ecurinë e proceseve të ndryshme bazuar në mbledhjen e të dhënave në kohë reale. Bazuar në punën e bërë ndër vite, Agjencia disponon një nga platformat më të rëndësishme të të dhënave në arsimin e lartë e cila përveç mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave mundëson kryerjen online të procedurave në kuadrin e akreditimit të institucioneve/programeve të arsimit të lartë si:

- Menaxhim i procedurave të akreditimit institucional dhe programeve të studimit me ndërfaqe të dedikuara;
- Vlerësime në kuadrin e akreditimeve të para dhe periodike;
- Menaxhim të komunikimeve elektronike e postare;
- Menaxhim shërbimesh nga IAL dhe ndjekje në kohë të proceseve në etapa të ndryshme;
- Komunikim me institucionet dhe ekspertët;
- Realizim i vlerësimit *on-line* për IAL dhe programe nga ekspertë vendas dhe të huaj;
- Plotësim të pyetësorëve dhe publikimi i rezultateve;
- Version “*mobile application*”, për AMS;
- Akses për përdoruesit i cili mundësohet nëpërmjet modulit *on-line* me mundësi aksesimi sipas hierarkisë dhe funksionit.

Edhe në vitin 2019 AMS e ka lehtësuar menaxhimin e proceseve të akreditimit pavarësisht sasisë së informacionit të administruar. Në 2019 AMS u pasurua edhe me opsione shtesë për ta përmirësuar më tej funksionalitetin e tij. Specifikisht u shtuan opsionet e vlerësimit të ekspertëve si dhe vlerësimit të koordinatorëve teknike të procedurave nga IAL-të përkatëse, që parashikohet të bëhen operative në vitin 2020 dhe kanë synim përmirësimin e punës së ASCAL si dhe rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjen. Në tërësi, AMS, nga IAL-të dhe ekspertët e vlerësimit, ka marrë vlerësim maksimal për lehtësinë, efikasitetin, transparencën dhe mundësitë që ofron për proceset që menaxhohen nëpërmjet këtij sistemi.

### 3.2 ADMINISTRIMI I PROCESEVE TË VLERËSIMIT DHE MONITORIMI I CILËSISË

Në vitin 2019, nëpërmjet AMS, ASCAL ka realizuar rreth **2520** shërbime / procese/procedura (akreditime, vlerësime, raportime, etj). Në bazë të “*Manualit për procedurën dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit*”, janë digjitalizuar të gjitha hapat që ndiqen në një procedurë vlerësimi për akreditimin institucional ose programeve të studimit.

Nëpërmjet AMS, për një procedurë akreditimi janë ndjekur hapat si vijon:

- Aplikimi për akreditim gjatë periudhës 1 tetor – 31 maj, të paktën 1 vit para diplomimit të studentëve të parë për institucionet e reja apo përfundimit të akreditimit të parë ose akreditimit periodik;
- Shqyrtimi paraprak i përputhshmërisë ligjore të kërkesës së akreditimit dhe verifikimi i bazës ligjore të funksionimit të institucionit nga data e themelimit (për institucionet me akreditim të parë) dhe nga data e akreditimit paraardhës.
- Miratimi i periudhës së akreditimit nëpërmjet konfirmimit për fillimin e procesit të akreditimit duke përcaktuar periudhën e akreditimit (datën e fillimit dhe mbarimit të procesit);
- Ngarkimi elektronik i RVB-ve;
- Shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ dhe dërgimi i draft-RVJ-ve dhe i RVJ final.

Gjatë vitit 2019, në çdo hap të procesit të akreditimit, stafi i ASCAL ka qenë në kontakt me kordinatorët e IAL-ve duke shkëmbyer informacione dhe dokumente nëpërmjet AMS. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të aplikimeve për akreditime në 2019, ndjekja në kohë reale e procedurave nëpërmjet AMS ka ndihmuar të gjithë aktorët të koordinojnë aktivitetet duke respektuar afatet kohore dhe njëkohësisht duke rritur transparencën.

Në fillimin e vitit akademik 2019-2020, IAL-të nëpërmjet koordinatorëve dhe në përgjigje të kërkesës së ASCAL, kanë depozituar informacion të përditësuar në AMS për stafin e tyre akademik, ndryshimet strukturore, programet aktive dhe jo aktive, studentët që ndjekin studimet për vitin akademik 2019-2020, etj. ASCAL ka shqyrtuar të dhënat e depozituara përkundrejtë standardeve dhe kritereve për sigurimin e cilësisë dhe kur ka qenë e nevojshme ka kërkuar informacione shtesë ose saktësim të dhënash.

Si rezultat i informacionit të mbledhur ndër vite, aktualisht AMS përbën databazën më të madhe të arsimit të lartë në Shqipëri. Në këtë databazë, vetëm gjatë vitit 2019 janë administruar rreth 400 dokumente të ndara sipas llojit, kategorisë, gjuhës, etj. Po ashtu nëpërmjet AMS, janë regjistruar një numër i madh komunikimesh ndërmjet ASCAL, BA, ekspertëve dhe IAL-ve si dhe janë shkëmbyer mjaft dokumente shtesë ose informuese. I gjithë informacioni, i ruajtur në AMS, është lehtësisht i administrueshëm dhe i përdorshëm në funksion të çdo procesi /procedure dhe aktiviteti të ASCAL dhe BA duke rritur transparencën dhe gjithëpërfshirjen.

### 3.3 INFORMIMI DHE PUBLIKIMI I INFORMACIONIT

ASCAL, në funksion të transparencës dhe informimit të publikut, ndër vite ka ndërtuar një sistem të konsoliduar për dhënien e informacionit dhe informimin e publikut bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Në përputhje me Nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ASCAL ka miratuar programin e transparencës dhe e ka publikuar në faqen zyrtare. Ky program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL / BA, nëpërmjet pasqyrimit në faqen zyrtare si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit e cila pasqyron *menu*-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare. Në këtë program transparence ASCAL ka paraqitur gjithashtu mekanizmin dhe formën e dhënies së informacionit si dhe kontaktet zyrtare për marrjen e informacionit elektronik.

Për **vitin 2019**, referuar regjistrimit të dhënies së informacionit, ASCAL u është përgjigjur zyrtarisht dhe ka dhënë informacion / dokumente, **76 kërkesave** të regjistruara me numër rendor si dhe mbi **60 kërkesave** të administruara në formë elektronike. Shpesh, këto kërkesa, të depozituara nga individë të ndryshëm, kanë patur të njëjtin objekt. Kërkesat për informacion ose dokumente kanë ardhur dhe janë administruar dhe nëpërmjet komunikimeve elektronike, si AMS, *e-mail*, etj. Stafi i ASCAL gjatë vitit 2019 ka dhënë informacione dhe sqarime të ndryshme edhe nëpërmjet AMS (kryesisht për IAL, BA dhe ekspertët) dhe u është përgjigjur *e-mail*-ve të publikut në tërësi duke u dhënë informacionin e kërkuar ose duke i adresuar në institucionet kompetente.

Në kuadër të transparencës dhe informimit në kohë reale, faqja zyrtare e ASCAL mundëson informacion për publikun dhe palët e interesuara në format të kuptueshëm. Faqja e ASCAL lexon të dhënat në kohë reale nga AMS duke

garantuar për publikun dhe palët e interesuara informacion të përditësuar dhe të besueshëm. Edhe në vitin 2019, në faqen zyrtare të ASCAL janë pasqyruar aktivitetet e Agjencisë dhe BA si dhe vendimet për akreditimin e programeve të studimit dhe IAL-ve. Nëpërmjet 'search engine' në faqen e ASCAL, studentët, publiku i gjerë si dhe palët e tjera të interesuara mund të marrin informacion të plotë mbi vlefshmërinë e akreditimit të programeve të studimit apo IAL-ve, proceset e vlerësimit që kanë kaluar programet e studimit dhe IAL-të si dhe RVJ-të përkatëse.

Në mënyrë të përmbledhur, disa nga informacionet e të dhënat që i vihen në dispozicion publikut dhe palëve të interesuara nëpërmjet faqes zyrtare të ASCAL janë:

- Informacion për procesin e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit me të dhëna për çdo proces të zhvilluar nga çdo program studimi dhe IAL;
- Raporte të vlerësimit të jashtëm institucional ose të programeve të studimit;
- Vendime të KA dhe BA, urdhëra të MASR, etj.;
- Publikime të akteve/bazës ligjore mbi të cilat bazohet procesi i vlerësimit të jashtëm si Ligji 80/2015, VKM 109 datë 15.02.2017, i ndryshuar, VKM 531 datë 11.09.2018, etj.;
- Raporte vjetore, rregullore, udhëzues, modele RVB dhe RVJ, etj.

### 3.4 SISTEMI I RUAJTJES, ARKIVIMIT TË INFORMACIONIT DHE I SHËRBIMEVE

Procesi për menaxhimin dhe administrimin e informacionit/dokumentacionit në ASCAL zbatohet nga arkiva/protokolli i institucionit. Çdo dokument ruhet në formë fizike dhe elektronike në arkivën dhe databazën e institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, "*Për arkivat*". Në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera të ruajtjes së informacionit zyrtar, ASCAL klasifikon informacionin sipas statusit të tij, *publik, përdorim të brendshëm, konfidencial, dhe sekret*. Po ashtu dhe aksesin në dokumentacion për stafin e ASCAL, BA dhe ekspertët, bëhet në funksion të procesit/procedurës së cilës i përket dokumentacioni. Aspekte të përdorimit të informacionit të brendshëm të ASCAL dhe mënyrës së dhënies së tij, janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit. Në funksion të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, së bashku me dosjen e printuar, në ASCAL dorëzohet edhe versioni elektronik i saj.

## KAPITULLI IV

### PLANI I VEPRIMTARIVE PËR VITIN 2020

ASCAL ka si objektiv kryesor (i) sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes vlerësimit të jashtëm, (ii) ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe (iii) përmirësimin e cilësisë së IAL-ve dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. ASCAL gjithashtu synon të anëtarësohet në Rrjetin European të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe të regjistrohet në Regjistrin European të Agjencive (EQAR).

Referuar synimeve të mësipërme, gjatë vitit 2020, ASCAL parashikon të zhvillojë aktivitetet si më poshtë:

1. Zhvillimi i procedurave/aktiviteteve në kuadër të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, specifikisht:
  - a. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit;
  - b. Vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të brendshme të cilësisë në IAL;
  - c. Bashkëpunimi me IAL për mbarëvajtjen e proceseve të vlerësimit të jashtëm;
  - d. Mbështetja e veprimtarisë së Bordit të Akreditimit;
  - e. Aktivitete në bashkëpunim me aktorë të tjerë në fushën e arsimit të lartë.

Lidhur me sa më sipër ASCAL parashikon të përfundojë të gjitha proceset e vlerësimit të mbartura nga viti 2019.

2. Vizitë studimore/shkëmbim eksperience në agjencitë e sigurimit të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë në Bullgari dhe Kroaci me mbështetje nga ‘Bologna peer support group on quality assurance’;
3. Asistencë për përgatitjen e akteve të nevojshme për miratimin e strukturës së ASCAL që t’i përshtatet kërkesave të shtuara ndaj institucionit;
4. Përmirësim/përditësim/plotësim i akteve ligjore ku kërkohet mendimi / kontributi i ASCAL në zbatim të VKM Nr. 837 datë 24.12.2019 “Për miratimin

e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020”;

5. Pjesëmarrje aktive (si partner) në projektet ndërkombëtare në të cilat ASCAL është partner;
6. Përmirësim i kushteve infrastrukturore ku ushtron aktivitetin ASCAL dhe logjistikës në dispozicion të stafit të Agjencisë;
7. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të funksionimit të Agjencisë, ASCAL do të vazhdojë *marrjen e mendimeve nga ekspertët e huaj dhe vendas të vlerësimit të jashtëm si dhe IAL-të* me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave të Agjencisë.